



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 560 Prot.

Tiranë, më 01.04.2025

VENDIM

Nr. 18, datë 01.04.2025

“Për avancim në titullin akademik dhe rishpallje e një vendi për titullin akademik”

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin e Asamblesë nr. 12, datë 28.2.2025 “Për miratimin e veprimtarisë së Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2024, programin dhe prioritetet e veprimtarisë së saj për vitin 2025, disa shtesa dhe ndryshime në Statut dhe miratimin për fillim procedure për kandidatës që kanë aplikuar për avancim në titullin akademik dhe rishpallje e një vendi për titullin akademik. Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Fillimi i procedurës së avancimit për titullin akademik për tre kandidatë të asociuar.
2. Seksionet të ushtrojnë kompetencat e tyre sipas nenit 7, pika 10 e Statutit, bazuar në kërkesat e Aneksit nr. 2, deri më datë 30 prill 2025. Depozitimi i dokumentacionit të kandidimit bëhet pranë komisionit Teknik.
3. Rishpalljen për 1 (një) vend për shkencën e historisë për titullin akademik.
4. Paraqitja e interes për konkurrim është nga data 1 prill 2025 deri më datë 30 prill 2025. Verifikimi e shqyrtimi i plotësimit të kriterëve ligjore nga komisioni teknik pranë ASH bëhet nga data 30 prill 2025 deri më datë 10 maj 2025.
 - 4.1 Dokumentet që kërkohen për kandidimin, për pikën 3:
 - Kërkesë për kandidim me mbështetjen e parashikuar në nenin 7, pika 5 e Statutit të ASH, në të cilin thuhet: “Kandidimi bëhet nga çdo i interesuar, me mbështetjen e dy akademikëve ose dy ekspertëve, me së paku me gradën “doktor i shkencave”;

- CV e plotë, përfshirë bibliografinë e plotë të botimeve, e ndarë para marrjes së titullit “Profesor” dhe pas tij;
 - Dokumenti i marrjes së titullit “Profesor”, fotokopje e noterizuar.
 - Plotësimi i “Formularëve të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” – referuar ligjit nr. 138/2015, “Për organizimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
 - Plotësimi i formularit referuar ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
5. Vlerësimi i motivuar nga njësia bazë universitare a kërkimore ku punon ose ka ushtruar aktivitetin kryesor kandidati, si dhe nga senati apo këshilli shkencor ku kandidati ka fituar titullin “Profesor”. Vlerësimi bëhet përmes votës konsultative për mbështetjen ose jo të kandidaturës, nga data 10 maj 2025 deri më datë 20 qershor 2025.
 6. Shqyrtimi i kandidaturave në komisionet dhe seksionet shkencore të ASH bëhen në periudhën 20 qershor 2025- 5 korrik 2025.
 7. Votimi i kandidaturave në Asamblenë e ASH bëhet deri në fund të muajit korrik 2025.
 8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Sekretari shkencor për dërgimin e njoftimit IAL-ve publike “Thirrje për pjesëmarrje”, kryetarët e seksioneve dhe komisioni teknik i verifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

